

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Jo në emrin tim"/ Nga Londra nis zëri që kërkon drejtësi për çlirimtarët
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/jo-ne-emrin-tim-nga-londra-nis-zeri-qe-kerkon-drejttesi-per-clirimtar-et-i106372
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 06:17:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 06:09:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c386c3cc66f21b6a970626d6f96a48c9b6c9d0106377b6435b203487e50281cb
TEKSTI	a27b2e1ff7e73528b25a426c598459045f84abe1db28acd74f21e866c17c1ab9
PAMJA	e5efedc0d155ca42fa0c2ab54de112528231a114325897f0a3022ee64662a284

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0ea9f595bfbee928d349e512ff2a2f35d66a172f8b9ebb02dcabb5b5207f3656
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2fad39eb4a5630a03d13ec48550b069ca76ccbe736c7b94b7af60112a505f929
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0ea9f595bfbee928d349e512ff2a2f35d66a172f8b9ebb02dcabb5b5207f3656>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash: **Sigurisë Kombëtare** Pallatin e Brigadave, K... ■ **largimin e qeverisë:** qeverisë Rama. Për më ■ **i motit për sot** parashikohet i kthjellët ndërsa ■ **përfundojnë në landfill** pavarësisht investimeve të reja në ■ **qe presin 12 shenjat e zodiakut** për asgjë. Për

KOSOVA

“Jo në emrin tim”/ Nga Londra nis zëri që kërkon drejtësi për çlirimtarët

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 08:09



Në qendrën e kryeqytetit britanik, në një prej qyteteve ku vendoset dhe debatohet çdo ditë për fatet e botës, zëri i shqiptarëve u ngrit fort.

Studentë, intelektualë, punëtorë, familje, fëmijë dhe qytetarë shqiptarë u mbledhën në Londër për të protestuar kundër dënimit të katër prej figurave kryesore të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Mes flamujve kuqezi, pankartave dhe thirrjeve për drejtësi, një slogan përsëritej mbi turmën:

“JO NË EMRIN TIM!”

Ishte një mesazh i drejtpërdrejtë: mos përdorni emrin e popullit të Kosovës për të folur në emër të të gjithë shqiptarëve.

Më 16 shtator 2026, Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë shpallën aktgjykimin e shkallës së parë ndaj katër ish-drejtimesve të UÇK-së. Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burg, Kadri Veseli me 18 vjet dhe Rexhep Selimi me 13 vjet — gjithsej 81 vjet burgim. Gjykata i shpalli fajtorë për krime lufte që lidhen me ndalime arbitrare, trajtim mizor, torturë dhe vrasje. Të katër u shpallën të pafajshëm për gjashtë akuzat për krime kundër njerëzimit. Aktgjykimi nuk është ende i formës së prerë.

Por për shumë prej protestuesve në Londër, çështja nuk mbaron me leximin e një vendimi.

Përkundrazi, aty fillon pyetja.

Si u ndërtua zinxhiri i përgjegjësisë?

Cilat janë provat që lidhin në mënyrë individuale secilin prej katër të dënuarve me secilin prej veprave për të cilat u shpallën përgjegjës?

A duhet të jetë e mundur që përgjegjësia e një drejtuesi të vendoset pa u përcaktuar dhe pa u dënuar autorët fizikë të veprave konkrete?

Kjo nuk është thjesht një pyetje politike.

Është një pyetje juridike që kërkon përgjigje juridike.

“Nëse një lojtar godet kundërshtarin, nuk dënohet trajneri pa u shqyrtuar më parë veprimi i lojtarit”

Ndoshta një nga momentet më domethënëse të protestës ishte ai që erdhi nga dy 13-vjeçarë shqiptarë, futbollistë të ekipit 31 Korriku të Burrelit në Londër.

Ata e shpjeguan çështjen me gjuhën e tyre, atë që njohin më mirë: futbollin.

“Nëse gjatë një ndeshjeje një lojtar godet me grusht kundërshtarin, nuk dënohet trajneri pa u ndëshkuar fare lojtari që e kreu veprimin. Kjo është absurde. Si mund të dënohen drejtuesit e luftës për vrasje, kur nuk dënohet ai që e ka krerë vrasien?”

Një pyetje e thjeshtë.

Ndoshta tepër e thjeshtë për një çështje kaq komplekse juridike.

Por pikërisht për këtë arsye ajo meriton të dëgjohet.

Sepse në një gjykim për përgjegjësi penale nuk mjafton vetëm pyetja “çfarë ndodhi?”

Duhet të përgjigjesh edhe:

Kush e bëri? Kush urdhëroi? Kush e dinte?

Çfarë prove e lidh secilin person me veprën?

Dhe a është provuar kjo përtej dyshimit të arsyeshëm?

Vetë Dhomat e Specializuara bëjnë të qartë se çështja kundër Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit nuk u bazua thjesht në pretendimin se ata ishin drejtues të UÇK-së. Paneli e ndërtoi përgjegjësinë e tyre përmes koncepteve të përgjegjësisë penale individuale dhe kontributit të tyre të konsiderueshëm në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Në proces dëshmuar 134 dëshmitarë në sallë dhe u administrua një material shumë i gjerë provash.

Pikërisht këtu qëndron debati.

Jo te mohimi i ekzistencës së viktimave. Jo te mohimi i vuajtjeve. Por te standardi me të cilin një individ shpallet penalisht përgjegjës për krime të kryera nga persona të tjerë.

Ky është një debat që duhet të bëhet me dokumente, prova dhe ligj.

Në protestë ishin edhe ata që e kanë jetuar luftën

Mes protestuesve në Londër kishte edhe dy ish-luftëtarë të UÇK-së.

Njëri prej tyre mbante në trup tri plagë të marra gjatë luftës.

Prania e tyre i dha protestës një dimension tjetër.

Ata nuk kishin ardhur të flisnin për luftën nga librat.

Dhe për ta, UÇK-ja nuk ishte thjesht një emër në një dosje gjyqësore.

Ishte një kapitull i jetës së tyre.

Ishte lufta në të cilën kishin hyrë me trupin e tyre.

Ishte liria që ata besojnë se u fitua me sakrificë.

Nga qeveria britanike drejt Trafalgar Square

Protestuesit u mblodhën pranë institucioneve qeveritare britanike dhe më pas marshuan drejt Trafalgar Square, një prej hapësirave më të njohura të Londrës për demonstrata dhe tubime publike.

Për rreth tri orë, thirrjet për drejtësi dhe liri u ndërthurën me emrat e katër ish-drejtimesve të UÇK-së:

“Hashim Thaçi!” “Kadri Veseli!” “Jakup Krasniqi!” “Rexhep Selimi!”

“DREJTËSI!” “LIRI!” “JO NË EMRIN TIM!”

Ishte një protestë që nuk u zhvillua në Prishtinë.

U zhvillua në Londër.

Dhe pikërisht kjo e bën mesazhin e saj të veçantë.

Sepse Londra është një qytet ku shqiptarët kanë ndërtuar jetën e tyre, kanë punuar, kanë studiuar dhe kanë rritur fëmijët e tyre.

Por është edhe qyteti ku drejtësia, institucionet dhe respektimi i shtetit të së drejtës janë pjesë e një tradite të gjatë publike.

Prandaj mesazhi i protestuesve ishte i qartë:

Ne kërkojmë drejtësi.

Ne kërkojmë transparencë.

Ne kërkojmë që çdo akuzë të mbështetet në prova.

Dhe kërkojmë që askush të mos flasë në emrin tonë pa na dëgjuar.

Një vendim i shkallës së parë, jo fjala e fundit

Ka edhe një fakt që nuk duhet harruar.

Vendimi i 16 shtatorit është aktgjykim i shkallës së parë. Ai mund të apelohej dhe nuk është ende vendim përfundimtar.

Kjo do të thotë se beteja juridike nuk ka përfunduar.

Dhe nëse mbrojtja beson se gjykata ka gabuar në vlerësimin e provave, në interpretimin e ligjit apo në përcaktimin e përgjegjësisë individuale, vendi ku këto pretendime duhet të provohen është procesi i apelit.

Aty duhet të flasin dosjet. Aty duhet të flasin provat. Aty duhet të flasë ligji.

Protesta e Londrës ishte vetëm fillimi

Tubimi i sotëm nuk u paraqit nga organizatorët si fundi i një beteje.

Ai u përshkrua si fillimi i një serie protestash që pritet të jenë edhe më të mëdha në ditët në vazhdim.

Nëse kjo lëvizje do të zgjerohet, një gjë është e sigurt:

çështja e katër ish-drejtimesve të UÇK-së nuk është mbyllur në ndërgjegjen e një pjese të shqiptarëve.

Dhe nga Londra, në zemër të diplomacisë botërore, u dëgjua sot një mesazh i vetëm:

Jo si refuzim i drejtësisë.

Por si kërkesë që drejtësia të jetë e njëjtë për të gjithë. Jo si mohim i viktimave.

Por si kërkesë që çdo përgjegjësi penale të provohet me standardin më të lartë të ligjit.

Jo si harresë e së kaluarës.

Por si kërkesë që historia e një populli të mos shkruhet vetëm nga aktgjykimet, por të ballafaqohet me të gjitha provat, dëshmitë dhe të vërtetat e saj.

Dhe kësaj here, mesazhi ishte i qartë:

Mos flisni në emrin tonë. Drejtësia nuk ka emër kombi. Nuk ka uniformë. Nuk ka flamur.

Dhe nuk duhet të ketë standard të dyfishtë.

Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 27 Shtator22:54

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK, mijëra persona mbledhen në Prishtinë](#)

Mijëra qytetarë janë mbledhur sonte në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, në mbështetje të ish-krerëve të UÇK.

KOSOVA 27 Shtator18:27

[“200 metrat” që liruan Gotovinën dhe mësimi për katërshtetë e UÇK-së](#)

Gjykata konstatoi se Gotovina dhe gjenerali Mlladen Markaç kishin marrë pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kri...

KOSOVA 27 Shtator15:58

[“Dosja 23” në Zubin Potok/ 9 të arrestuarit për krime lufte ndalohen për 48 orë, publikohen pamjet nga aksioni](#)

Prokuroria Speciale dhe Policia e Kosovës kanë publikuar të dhëna të reja dhe pamje nga aksioni i sotëm në Zubin Potok, ku u ...

KOSOVA 27 Shtator15:34

[REL: Nga dënimi te pafajësia, ja çfarë mësimi sjell rasti Gotovina për apelin e ish-krerëve të UÇK-së](#)

Pas dënimit për krime lufte të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli...

KOSOVA 27 Shtator10:01

[Kosova i kërkon dorëheqjen, ministrja e Drejtësisë: S’kam bashkëpunuar me Hagën](#)

Ministrja e Drejtësisë e Kosovës, Donika Gërvalla, mohoi se ka bashkëpunuar me Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe tha se...

KOSOVA 26 Shtator17:26

[Edhe pulat nga Tajlanda/ 197 tonë mish përmes Kosovës, raporti i KE ngre pikëpyetje për kontrollet](#)

Shqiptarët konsumojnë mish pule nga Tajlanda. Që prej 3 shtatorit, BE-ja dhe vendi ynë kanë ndaluar importin e disa kategorive të ...

KOSOVA 26 Shtator12:14

[Të shtëna me armë në aksin Prishtinë-Ferizaj, tre të plagosur](#)

Të shtëna me armë zjarri janë regjistruar mëngjesin e kësaj të shtune në aksin Prishtinë-Ferizaj. Mësohet se n...

KOSOVA 25 Shtator23:33

[Aksidenti i rëndë pranë Bujanocit, vdes nëna dhe i biri](#)

Një tragjedi e rëndë ka ndodhur sot, të premten, pranë Bujanocit, ku në një aksident të rëndë trafiku kanë...

KOSOVA 25 Shtator22:28

[Haziri në protestën e natës së dhjetë: UÇK-ja nuk është temë ditore](#)

Sonte Kosova ka hyrë në ditën e dhjetë të protestave kundër aktgjykimit dënues ndaj ish-krerëve të Ushtrisë &C...

KOSOVA 25 Shtator21:57

[Rama zhgënjën Kosovën, asnjë fjalë për UÇK-në në fjalimin para OKB-së](#)

Në Kosovë kishte një pritshmëri të lartë se Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama do t’i kushtonte hapësirë...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 27 Shtator

[Familja e kërkon prej vitesh/ Emisioni italian ...](#)

Rajmonda Kotorri, e cila u largua në Itali kur ishte vetëm 16 vjeçe dhe humbi kontaktet për vite me radhë me familjen e saj, dyshohe...

AKTUALITET 27 Shtator

[I martuar me një grua ruse, si u kap gafil elba...](#)

Detaje të reja kanë dalë nga operacioni, për kapjen në Rusi të Salvatore alias Shpëtim Aliut në Federatën Ruse, ku ...

AKTUALITET 27 Shtator

[“Je rrezik për sigurinë kombëtare”, Azgan Hakla...](#)

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Azgan Haklaj, është ndaluar nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut në pikën kufitare t&...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.